



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo lokalne samouprave
Ministry of Local Government*

PUSHTETI LOKAL NË KOSOVË DHE OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM



PUSHTETI LOKAL NË KOSOVË DHE OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Çka janë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm?

Në vitin 2015, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm me 17 Objektivat e saj të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të), për të promovuar: **qëndrueshmërinë sociale, mjedisore dhe ekonomike**. Që atëherë, akterë të ndryshëm kanë mobilizuar përpjekjet për ta **luftuar varfërinë, për ta promovuar rritjen ekonomike dhe për t'i zvogëluar pabarazitë**.

Edhe pse u lansua nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, përfituesit e synuar të kësaj Agjende janë qytetarët ndërsa zbatuesit kryesorë të saj, organet e pushtetit lokal. OZHQ-të krijojnë një shteg për të gjithë.

Në vitin 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi Rezolutën për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe themeloi Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm. Në këtë mënyrë, Kosova u zotua për zhvillimin e treguesve të saj kombëtarë për të ndihmuar në monitorimin e progresit të arritur në objektivat dhe synimet e sajë në zhvillimin e pushtetit lokal. Një nga shembujt më të mirë të një mekanizmi të tillë është Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale i Ministrisë së Pushtetit Lokal.

Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) dhe OZHQ-të - Si ndërlidhen këto?

Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) është një mekanizëm në kuadër të Ministrisë së Pushtetit Lokal (MPL) që mat performancën e komunave në ofrimin e **shërbimeve administrative dhe shërbimeve publike si dhe në qeverisje**.

Ky mekanizëm përbëhet nga **119 tregues të performancës** që përdoren nga MPL-ja në baza vjetore për ta analizuar performancën e komunave të Kosovës.



Cili është qëllimi i Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK)?

Një nga qëllimet kryesore të SMPK-së është t'ua mundësojë MPL-së dhe Qeverisë të ndikojnë në rritjen e përgjegjësisë dhe efikasitetit të komunës, të mundësojnë përmirësimin e shërbimeve publike përmes një sistemi të kriterëve dhe standardeve të përcaktuara. Misioni i SMPK-së është të fuqizojë aftësinë e komunave për t'i përmirësuar shërbimet publike.

Si ndërlidhen pushteti lokal me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të)?

Përpjekjet e qeverisë qendrore dhe lokale janë thelbësore për t'i arritur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Qeveria lokale është në pozitë të mirë që t'i trajtojë çështjet që lindin nga OZHQ-të dhe të punojnë drejt progresit të kërkuar. Detyrat si planifikimi hapësinor, mirëqenia sociale, mirëmbajtja e rrugëve lokale, transporti publik, menaxhimi i mbeturinave, ujit dhe kanalizimit etj. janë detyrat më të zakonshme për pothuajse çdo nivel lokal. Ndërsa qeverisë qendrore i takon që të sigurojë burime për adresimin e nevojave, përgjegjësia bie mbi pushtetin lokal që të sigurojnë që ato burime të përdoren për arritjen e OZHQ-ve, në mënyrë efikase dhe efektive. Kjo e vë qeverinë lokale në rolin e akterëve kryesorë në procesin e arritjes së OZHQ-ve. Për këtë qëllim, Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale ka harmonizuar një numër të treguesve të tij për të kontribuar drejtpërdrejt në arritjen e OZHQ-ve.

Cili është përfitimi për qytetarët?

Qytetarët përfitojnë shërbime më të mira publike, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre të përditshme dhe në mirëqenien e tyre. Këta faktorë kontribuojnë gjithashtu në rritjen e besimit të qytetarëve në qeverisjen lokale.



Çka përfitojnë komunat?

Komunat përdorin një metodologji të standardizuar të cilën e ofron SMPK-ja për ta matur dhe vlerësuar performancën e tyre dhe cilësinë e shërbimeve të tyre publike. Përmes këtij sistemi, komunat njoftohen se çfarë duhet të përmirësojnë në shërbimet që ofrojnë.

Kush janë grupe të interesuara në SMPK?


Vetë komunat - është në interes të kryetarëve të komunave, kuvendeve komunale dhe zyrtarëve të tjerë komunalë që të kenë njohuri për performancën e tyre, se si performanca e tyre krahasohet me performancën e komunave të tjera, dhe që të shmangin dobësitë në të ardhmen.

Qytetarët, komunitetet lokale dhe shoqëria civile - kanë interes të kenë shërbimin më të mirë të mundshëm. Këto shërbime duhet të jenë efikase dhe efektive, transparente dhe të kenë arritur përgjegjshmërinë e vendimmarrjes komunale.

Donatorët, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë - SMPK-ja ka potencialin që t'i informojë më mirë ministritë e linjës për performancën komunale dhe të gjenerojë të dhëna të shërbimeve për këto fusha. Ky sistem treguesish kontribuon në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Cilado strategji e zhvilluar pas miratimit të rezolutës nga Kuvendi i Kosovës duhet t'i përfshijë elementet e OZHQ-ve.

Pushteti lokal luan një rol vendimtar në promovimin e politikave lokale të zhvillimit të qëndrueshëm, investimeve direkte kapitale dhe përmirësimit të shërbimeve.

Treguesit e SMPK-së, të cilët kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e OZHQ-ve, janë renditur më poshtë:



SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE



3.1

Deri në vitin 2030, të reduktojë nivelin global të vdekshmërisë së nënave në më pak se 70 vdekje për 100,000 lindje të gjalla

3.2

Deri në vitin 2030, fundi i vdekjeve të parakohshme të të sapolindurve dhe fëmijëve nën moshën 5 vjeçare

3.7

Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje universale në SHËRBIMET E KUJDESIT SHËNDETËSOR SEKSUAL DHE RIPRODHUES. Këto përfshijnë planifikimin familjar, informimin dhe edukimin, si dhe integrimin e shëndetit riprodhues në strategji dhe programe kombëtare.

KUJDESI PRIMAR SHËNDETËSOR



18.3.2

Fëmijët e përfshirë në programin e imunizimit

18.3.3

Ofrimi i shërbimeve specifike të kujdesit primar shëndetësor për gra dhe fëmijë.

ARSIM CILËSOR



4.1

Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjitha vajzat dhe djemtë të përfundojnë ARSIMIN FILLOR DHE TË MESËM pa pagesë, të barabartë dhe cilësor, duke çuar në rezultate relevante dhe efektive të të nxënit

4.2

Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjitha vajzat dhe djemtë të kenë qasje në ZHVILLIM CILËSOR NË FËMIJËRINË E HERSHME, KUJDES CILËSOR DHE EDUKIM PARAFILLOR CILËSOR në mënyrë që të jenë të gatshëm për arsimin fillor



ARSIMI PARAUNIVERSITAR

17.3.2

Shkalla bruto e regjistrimit në klasën e 1-rë të shkollës fillore

17.3.3

Shkalla e qasjes - tranzicioni kl9- k10

17.3.4

Rezultatet nga testi i arritshmërisë për klasën e 9-të (të ndara për vajzat)

17.3.1

Fëmijët që vijojnë kopshtin - rural dhe përgjithësi (ndarje sipas gjinisë)

SDG 04

4.5

Deri në vitin 2030, të eliminohen pabarazitë gjinore në arsim dhe të sigurohet QASJE E BARABARTË NË TË GJITHA NIVELET E ARSIMIT dhe aftësimin profesional për ata që janë të cenueshëm, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, njerëzit indigjenë dhe fëmijët në situata të cenueshme

4.a

TË NDËRTOHEN DHE TË AVANCOHEN OBJEKTE ARSIMORE që janë të ndjeshme ndaj fëmijëve, ndaj paaftësisë dhe të ndjeshme ndaj aspektit gjinor si dhe të ofrohen për të gjithë ambiente mësimore të sigurta, jo të dhunshme, gjithëpërfshirëse dhe efektive

4.c

Deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm numri i mësimdhënësve të kualifikuar, përfshirë përmes bashkëpunimit ndërkombëtar për trajnimin e mësimdhënësve në vendet në zhvillim, veçanërisht në vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet e ishujve të vegjël në zhvillim

17.3.6

Indeksi i barazisë gjinore në arsimin parauniversitar


17.1.3

Shkollat e pajisura me laborator të TI-së dhe të internetit (ndërlidhet me 4.a.1 [b], [c])

17.2.1

Mësimdhënësit në të gjithë arsimin parauniversitar që plotësojnë kriteret e kualifikimit - të licencuar

BARAZIA GJINORE



5.1

T'i jepet fund kudo të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave

5.5

Të sigurohet pjesëmarrje e plotë dhe efektive e grave si dhe mundësi të barabarta për udhëheqje NË TË GJITHA NIVELET E VENDIMMARRJES NË JETËN POLITIKE, EKONOMIKE DHE PUBLIKE

5.c

Të miratohen dhe të fuqizohen POLITIKA TË SHËNDOSHA DHE LEGJISLACION I ZBATUESHËM për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave në të gjitha nivelet



PËRFAQËSIMI GJINOR

16.2.4

Plani komunal për barazi gjinore

16.1.2

Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive

16.1.3

Gratë e emëruara në pozita politike në komunë

16.2.1

Buxhetim dhe shpenzim i përgjegjshëm gjinor

UJË I PASTËR DHE KANALIZIM



6.1

Deri në vitin 2030, të arrihet një qasje universale dhe e barabartë në FURNIZIMIN ME UJË TË PIJSHËM TË SIGURT DHE TË PËRBALLUESHËM për të gjithë

6.2

Deri në vitin 2030, të arrihet qasje në KANALIZIM dhe higjienë të përshtatshme dhe të barabartë për të gjithë, dhe mos të ketë kullime në vende të hapura, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe të atyre në situata të cenueshme

6.3

Deri në vitin 2030, të përmirësohet cilësia e ujit duke ZVOGËLUAR NDOTJEN, duke eliminuar hedhjen dhe duke minimizuar shkarkimin e kimikateve dhe materialeve të rrezikshme, duke përgjysmuar proporcionin e ujërave të ndotura të patrajtuara, dhe duke RRITUR RIKIKLIMIN DHE RIPËRDORIMIN E SIGURT për x% [do të vendoset globalisht

UJË I PIJSHËM



12.1.2

Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe bizneset të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm

13.1.2

Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe bizneset e lidhura me sistemin e kanalizimit

13.2.1

Vendbanimet e përfshira në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza

SDG 06

6.a

Deri në vitin 2030, të zgjerohet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetja për ngritjen e kapaciteteve për vendet në zhvillim në aktivitete dhe programe që lidhen me ujërat dhe kanalizimet, duke përfshirë grumbullimin e ujit, shkripëzimin, efikasitetin e ujit, trajtimin e ujërave të zeza, riciklimin dhe teknologjitë e ripërdorimit

12.1.1

Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit

PUNË DINJOTOZE DHE RITJE EKONOMIKE



8.b

Deri në vitin 2020, të zhvillohet dhe funksionalizohet një strategji globale për punësimin e të rinjve dhe të zbatohet Pakti Global i Punës i Organizatës Ndërkombëtare të Punës



ZHVILIMI EKONOMIK LOKAL

19.1.1

Plani për zhvillimin ekonomik lokal

INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË



9.1

Të zhvillohet një INFRASTRUKTURË cilësore, e besueshme, e qëndrueshme dhe e fortë, përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare, në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies njerëzore, me fokus në QASJEN E BARABARTË DHE TË PËRBALLUESHME PËR TË GJITHË



INFRASTRUKTURA RRUGORE

9.1.1

Rrugët lokale të shtruar

9.1.3

Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit

QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME



11.1

Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje për të gjithë në SHËRBIME TË STREHIMIT DHE SHËRBIME BAZË të përshtatshme, të sigurta dhe të përballeshme, si dhe të përmirësohen lagjet e varfra

11.2

Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje në sisteme të transportit të sigurt, të përballeshëm, të qasshëm dhe të qëndrueshëm për të gjithë, duke përmirësuar sigurinë në rrugë, veçanërisht duke zgjeruar TRANSPORTIN PUBLIK, me vëmendje të veçantë për nevojat e atyre që janë në situata të cenueshme, gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit



BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE

4.2.1

Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi dhe janë krijuar kushtet për lëshim të banimit social



TRANSPORTI PUBLIK

10.1.1

Zbatimi i planit lokal për transportin publik

10.1.2

Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik

SDG 11

11.3

Deri në vitin 2030, të përmirësohet URBANIZIMI gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm dhe kapacitetet për PLANIFIKIM dhe menaxhim pjesëmarrës, të integruar dhe të qëndrueshëm të vendbanimeve për njerëzit në të gjitha vendet

11.5

Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndjeshëm numri i vdekjeve dhe numri i personave të prekur dhe të ulen për y% humbjet ekonomike në raport me BPV-në të shkaktuara nga fatkeqësitë, përfshirë FATKEQËSITË të lidhura me ujin, me fokus në mbrojtjen e të varfërve dhe njerëzve në situata të cenueshme

11.6

Deri në vitin 2030, të zvogëlohet NDIKIMI MJEDISOR NEGATIV I QYTETEVE për kokë banori, përfshirë duke i kushtuar vëmendje të veçantë CILËSISË SË AJRIT, MENAXHIMIT të mbeturinave komunale dhe të mbeturinave të tjera

PLANIFIKIMI HAPSINOR



7.1.1

Sipërfaqja e territorit të komunës i mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme)

MENAXHIMI I FATËKEQSIVE



6.1.2

Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë

MENAXHIMI I MBETURINAVE



14.1.1

Niveli i zbatimit të planit komunal të menaxhimit të mbeturinave

14.1.2

Ekonomitë familjare që kanë qasje në sistemin e grumbullimit të mbeturinave

14.3.1

Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori

SDG 11

11.7

Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje universale në HAPËSIRAT PUBLIKE DHE TË GJELBRA të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të qasshme, veçanërisht për gratë dhe fëmijët, personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara

11.a

Të mbështeten LIDHJET pozitive ekonomike, sociale dhe mjedisore NDËRMJET ZONAVE URBANE, PERI-URBANE DHE RURALE duke forcuar planifikimin e zhvillimit kombëtar dhe rajonal

11.b

Deri në vitin 2020, të rritet për x% numri i qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore që miratojnë dhe zbatojnë politika dhe plane të integruara drejt përfshirjes, efikasitetit të burimeve, zbutjes dhe përshtatjes ndaj NDRYSHIMIT KLIMATIK, REZILIENCËS NDAJ FATKEQËSIVE, të zhvillohet dhe zbatohet në përputhje me Kornizën e ardhshme holistike të Hyogo MENAXHIMI I RREZIKUT TË FATKEQËSIVE në të gjitha nivelet

HAPËSIRAT PUBLIKE



8.1.1

Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m2 për kokë banori

8.2.2

Sipërfaqja e shesheve publike në m2 për kokë banori

7.1.1

Territori komunal i mbuluar me planet rregulluese

6.1.1

Niveli i realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive

SDG 12

KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM



12.5

Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndjeshëm gjenerimi i mbeturinave përmes parandalimit, ZVOGËLIMIT, RICIKLIMIT DHE RIPËRDORIMIT

12.b

Të zhvillohen dhe zbatohen mjete për të monitoruar ndikimet e zhvillimit të qëndrueshëm për TURIZMIN E QËNDRUESHËM I CILI KRIJON VENDE PUNE, PROMOVON KULTURËN LOKALE DHE PRODUKTET

MENAXHIMI I MBETURINAVE



14.3.1

Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori

MBROJTJA E AMBIENTIT



15.1.1

Realizimi i planit të veprimit lokal në mjedis

ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL



19.1.1

Plani për zhvillimin ekonomik lokal

SDG 13

VEPRIM PËR KLIMËN



13.1

Të forcohet REZILIENCA dhe aftësia përshtatëse ndaj rreziqeve që lidhen me klimën dhe fatkeqësitë natyrore në të gjitha vendet




MENAXHIMI I FATËKEQSIVE

6.1.1

Niveli i realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive

SDG 16

PAQE DHE DREJTËSI, INSTITUCIONE TË FORTA



16.6

Të zhvillohen INSTITUCIONE EFEKTIVE, TË PËRGJEGJSHME DHE TRANSPARENTE në të gjitha nivelet

16.7

Të sigurohet VENDIMMARRJE E PËRGJEGJSHME, GJITHËPËRFSHIRËSE, PJESËMARRËSE DHE PËRFAQËSUESE në të gjitha nivelet



TRANSPARENCA KOMUNALE

2.2.1

Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit

16.1.3

Gratë e emëruara në pozita politike në komunë

16.1.2

Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive

16.2.2

Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave

PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT



17.1

Të fuqizohet mobilizimi i burimeve vendore, përfshirë edhe përmes mbështetjes ndërkombëtare për vendet në zhvillim për të përmirësuar kapacitetin vendor për INKASIMIN E TË HYRAVE NGA TATIMI DHE TË TË HYRAVE TJERA

17.14

Të forcohet KOHERENCA E POLITIKAVE për zhvillim të qëndrueshëm

17.17

Të inkurajohen dhe të promovohen PARTNERITETET efektive publike, publiko-private dhe ato me shoqërinë civile, duke u mbështetur në përvojën dhe sigurimin e burimeve

ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL



19.1.4


Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)

19.1.1


Plani për zhvillimin ekonomik lokal

19.1.2

Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim



Përkrahur nga: Projekti për decentralizim dhe përkrahja komunave (DEMOS)

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

 Sweden
Sverige



Norwegian Embassy
Prishtina

 **HELVETAS**
KOSOVO

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC